

MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Xhensila Pine, si anëtare e trupit gjykues, të subjektit të rivlerësimit, znj. Edlira Petri, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues, nëpërmjet të cilit është konfirmuar në detyrë subjekti rivlerësimit.

Më poshtë do të rendis arsyet e votës sime kundër, duke u ndalur dhe arsyetuar qëndrimet e mia kundër konkluzioneve që ka mbajtur shumica e trupit gjykues në këtë çështje, pa përsëritur argumentet e dhëna nga shumica për çështje, të cilat kam ndarë të njëjtin qëndrim me ta.

Kundërshtitë e mia në lidhje me vendimmarrjen e shumicës së trupit gjykues kanë të bëjnë me vlerësimin e kriterit të pasurisë, duke i renditur, si më poshtë.

1. Në pikën 86 të vendimit, e cila ka të bëjë me vlerësimin e pasurisë është pasqyruar deklarimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Edlira Petri, i kryer në deklaratën “Vetting” për pasurinë “apartament banimi” me sip. 99.5 m², në Qerret, Kavajë: *“Sipas certifikatës së pronësisë, datë 15.6.2012, në emrin tim dhe të bashkëshortit është regjistruar apartament me sipërfaqe 99.5 m² me adresë në Qerret, sqarim apartamenti është blerë nga bashkëshorti përpara martese, sqarime të detajuara lidhur me blerjen dhe burimin e krijimit gjenden te deklarimi i bashkëshortit, pjesa takuese 50 %”*.

2. Në deklaratën “Vetting”, bashkëshorti i subjektit, ka deklaruar *“apartament banimi blerë sipas kontratës, datë 5.9.2006, në vlerën 58.750 euro “ me burim krijimi“ të ardhurat dhe shitjen e një apartamenti, “ duke sqaruar se“ ka shitur një apartament në *** sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 4.12.2006, në vlerën 55.000 euro“*

3. Në deklarimin periodik vjetor të vitit 2006, bashkëshorti i subjektit, ka deklaruar *“kontratë sipërmarrje për ndërtimin e një apartamenti në Golem, me çmim 58.750 euro, i paregjistruar ende në ZVRPP nga sipërmarrësi shoqëria “***” sh.p.k., dhe nuk është përpiluar kontrata e shitjes“*.

4. Në lidhje me këtë pasuri ka dy situata kryesore, në të cilat kam ndarë mendim të ndryshëm nga shumica e trupit gjykues, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, si më poshtë:

4.1 Së pari, të drejtat e pronësisë së subjektit të rivlerësimit në këtë pasuri të paluajtshme të deklaruar prej saj në deklaratën “Vetting” dhe kohën e përfitimit të tyre referuar fakteve, provave dhe legjislacionit në fuqi.

4.2 Së dyti, përmbushjen nga subjekti i rivlerësimit të detyrimit kushtetues të justifikimit të burimit të ligjshëm të krijimit, për këtë pasuri, në përputhje me parashikimet ligjore të Aneksit të Kushtetutës.

5. Lidhur me situatën e parë – shumica e trupit gjykues ka vlerësuar se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit janë bindëse dhe përputhen me faktet e rezultuara gjatë hetimit, duke arsyetuar se pavarësisht se bashkëpronare mbi këtë pasuri rezulton të jetë regjistruar edhe subjekti i rivlerësimit, vetëm për shkak të procedurës së kryer në vitin 2011, për blerjen nga ALUIZNI të truallit në bashkëpronësi mes të gjithë pronarëve të apartamenteve të pallatit, kjo pasuri rezulton e blerë në vitin 2006 (para martese) dhe nuk mund të lidhet me procesin e rivlerësimit të znj. Edlira Petri.

Për sa më sipër, argumentet e mia kundërshtuese janë:

6. Për sa i përket të drejtave të pronësisë së subjektit të rivlerësimit në këtë pasuri të paluajtshme, qëndrimi deklarativ i subjektit të rivlerësimit se *...në kuptim të ligjit, e drejta e pronësisë që rezulton në regjistrat e pasurive të paluajtshme edhe në emrin tim, në fakt, vlerësoj se nuk ekziston*, nuk mund të konsiderohet, pasi për sa kohë pasuria figuron e regjistruar në

regjistrat e pasurive të paluajtshme në emër të saj (subjektit të rivlerësimit) dhe bashkëshortit, **e rrjedhimisht prezumohet se subjekti i rivlerësimit ka të drejtën e pronësisë**, në pjesë takuese 50 % mbi këtë pasuri, bazuar në sa neni 199, paragrafi 2,i Kodit Civil, përcakton se:“*Pjesët e bashkëpronarëve janë të barabarta, gjersa nuk vërtetohet e kundërta*”.

7. Referuar kuadrit ligjor kushtetues dhe legjislacionit për vlerësimin e kriterit të pasurisë gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, në asnjë dispozitë nuk parashikohen kriteret vlerësimi të kushtëzuara me qëllim përjashtimin e tyre nga objekti i kontrollit të organeve të rivlerësimit.

8. Subjekti i rivlerësimit, në deklarimin periodik vjetor të vitit 2012, rezulton që të ketë deklaruar regjistrimin në ZVRPP Kavajë të pronësisë mbi këtë apartament në Golem.

9. Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimin nr. 19, datë 26.7.2019, ka arsyetuar se nuk është në kompetencë të Komisionit të arsyetojë mbi prezumimin ligjor, mbi të drejtën e pronësisë së subjektit të rivlerësimit dhe se ky arsyetim kapërcen tagrat e nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, që e drejton shprehimisht procesin e rivlerësimit, për sa i përket kriterit pasuror vetëm në “*deklarimin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre dhe përmbushjen e detyrimeve financiare*”, në referim të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës

10. Nga faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ, pasuria e paluajtshme me sip. 99.5 m², në Qerret, ka qenë objekt i kontratës së sipërmarrjes lidhur në datën 5.9.2006 dhe ka rezultuar e provuar, sikundër është deklaruar se kjo ishte kontratë sipërmarrjeje dhe jo kontratë shitblerjeje.

11. Në vendimin nr. 313, datë 17.6.2015, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë arsyeton se: “

[...]“sipërmarrja është kontrata më të cilën njëra palë sipërmarrësi detyrohet, që me mjetet e tij dhe duke marrë përsipër rrezikun, të kryejë një vepër (punë) ose të bëjë një shërbim apo zbatim të pavarur të punimeve, ndërsa pala tjetër detyrohet ta pranojë atë kundrejt çmimit të caktuar në kontratë (Neni 850 i Kodit Civil).

Për sa më sipër kemi të bëjmë me detyrime kryesore (marrëdhënie detyrimi) reciproke të palëve kontraktore, subjektet e kësaj kontrate janë porositësi ose investitori dhe sipërmarrësi. Sipërmarrësi (debitori) detyrohet për prodhimin e veprës dhe dorëzimin e saj dhe porositësi ose investitori (kreditore) për pranimin e saj dhe pagimin e çmimit të kontraktuar.

Sipas nenit 705 të Kodit Civil, kontrata e shitjes ka për objekt kalimin e pronësisë së një sendi, ose kalimin e një të drejte, kundrejt pagimit të një çmimi. Nga sa më sipër rezulton se sendi duhet të jetë pjesë i qarkullimit civil dhe një karakteristikë e sendeve të paluajtshme e domosdoshme për të qenë objekt të një kontrate shitje është regjistrimi i tyre” [...].

12. Për sa kohë regjistrimi fillestar i saj në emër të shoqërisë ndërtuese u bë në vitin 2007, në referim të Vendimit Unifikues 1/2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë *[...]“thelbi i fitimit të së drejtës së pronësisë me titull të prejardhur, qëndron në faktin që pronari i ri e fiton të drejtën e pronësisë mbi sendin vetëm në qoftë se tjetërsuesi është pronar i tij. Vlen parimi antik, sipas të cilit asnjëri nuk mund t’u transferojë të tjerëve më shumë të drejta sa ka ai vetë ” [...].kjo pronë nuk mund të jetë shitur prej shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k.në vitin 2006.,*

13. Bashkëshorti i subjektit në deklarimin periodik të vitit 2006, ka deklaruar se kjo pronë nuk është regjistruar dhe nuk është hartuar ende kontrata e shitjes.

14. Nisur nga rrethanat juridike, fitimi i pronësisë së këtij apartamenti dhe momenti i kalimit të të drejtave të pronësisë është kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme me nr. **, datë 1.5.2012, koha kur palët kanë materializuar vullnetin, para organit të ngarkuar nga ligji, noterit publik, referuar nenit 83 dhe 705 të Kodit Civil.

15. Në vlerësim të provave ligjore të administruara, deklaratimet në deklaratën “Vetting” mbi kohën e fitimit të pronësisë për pasurinë “apartament banimi” me sip. 99.5 m², në Qerret, Kavajë, mbetën në nivel deklarativ, e të paprovuara me dokumentacion ligjor.

16. **Lidhur me situatën e dytë** – në pikat 93 - 96 të vendimit të Komisionit është analizuar burimi i krijimit të pasurisë, deklaruar prej subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting” nga marrëdhënia me z. M.M., nga e cila u përfitua *cash* shuma prej 55.000 euro.

17. Shtetasi M.M., pagoi një shume të madhe *cash* për blerjen e një prone, pa ndjekur formalitetet ligjore të detyrueshme duke u ndodhur në një marrëdhënie të mirëfilltë interesi, e cila rrjedh nga një interes pasuror, sipas fakteve më poshtë:

17.1 Me kontratën e shitjes së datës 29.1.2003 z. S.S., përfitoi të drejtën e pronësisë mbi apartamentin me sip. 86.5 m², ndodhur në ***, Kavajë.

17.2 Në datën 24.2.2003 ai u kreditua nga “Banka Kombëtare e Greqisë” për shumën 20.000 USD, duke vendosur si hipoteke për këtë kredi kete apartament i cili ka qëndruar i bllokuar në favor të Bankes, deri në likuidimin total të kredisë, në vitin 2008.

17.3 Në datën 4.12.2006, z. M.M., deklaroi para noterit se ka rënë dakord për të blerë apartamentin me sip. 86.5 m², ndodhur në ***, Kavajë. Çmimi për blerjen është 55.000 euro, shumë e cila do të përdoret për të blerë një apartament tjetër në Golem. Kontrata e shitjes, nuk është redaktuar, pasi kjo pronë është e bllokuar në regjistrin hipotekor, në favor të “Bankës Kombëtare të Greqisë”, për vlerën 20.000 USD.

17.4 Për sa kohë prona apartament me sip. 86.5 m², ndodhur në ***, Kavajë ishte vendosur si hipoteke në favor të bankës për të siguruar kredinë e marrë deri në vitin 2008, kalimi të blerësi i së drejtës së pronësisë, apo i të drejtave të tjera, nuk kanë qenë të disponueshme mes palëve, pasi ka pasur për to ndalim të parashikuar në ligj.

17.5 Referuar të dhënave të pasqyruara në regjistrat e QKB-së¹, z. M.M.,² nga data 18.6.2003 e vijim, ishte ortak i vetëm dhe administrator në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “****”; me objekt aktivitet ndërtimi, aktivitet i cili nga data 11.2.2004 u vendos në Golem.

17.6 Referuar EKB-së³, kosto e ndërtimit për apartament banimi me sip.86.5 m², në Golem ishte në vlerën 2.156.791 lekë.

17.7 Të ardhurat nga shtetasi M.M., në vitin 2006, rezultojnë të përfituara nga një transaksion kompleks financiar dhe marrëdhënie interesi e ndryshme me praktikat aktuale të tregut, me qëllim bërjen të disponueshme të kësaj shume, për t’u përdorur si burim krijimi për pasurinë e deklaruar në “Vetting”.

18. Sipas institutit të barrës së provës, subjektit të rivlerësimit iu kërkua nga Komisioni, **të shpjegonte burimin e ligjshëm të shumës**, përfituar nga shtetasi M.M., përdorur si burim krijimi për pasurinë e deklaruar në deklaratën “Vetting”.

19. Në përgjigje të barrës së provës, pavarësisht kërkesës së Komisionit, subjekti dështoi të provonte dhe të shpjegonte burimin e ligjshëm të kësaj shume.

20. Arsyetimi i përdorur nga shumica mbi pronësinë e kësaj pasurie, nuk ndryshon faktin se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë dokumentacion për të vërtetuar pas dërgimit të barrës

¹ Nga verifikimi kryer në faqen zyrtare “web” të QKB-së
<http://www.qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>

² Referuar të njëjtave gjeneralitete si hartuesi i deklaratës noteriale.

³ Kosto e ndërtimit për vitin 2006 në qytetin Kavajë ka qenë 24 934 lekë/m <https://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit-viti-2006/>

së provës, burimin e ligjshëm të shumës kërkuar posaçërisht për qëllim të kontrollit të pasurisë së deklaruar prej saj në deklaratën “Vetting”.

21. Lidhur me burimin e ligjshëm të pasurisë, tashmë ka një jurisprudencë të konsoliduar dhe të harmonizuar të Kolegjit të Apelit të cila ka shtjelluar në mënyrë shteruese se saktësia dhe mjaftueshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe shpjegimi bindshëm i burimit të ligjshëm të pasurisë në pronësi apo në përdorim të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur janë elementë përcaktues për kontrollin e plotë dhe vlerësimin e drejtë të kriterit të pasurisë.

21.1 Standardi i vendosur nga pika 3 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016, kërkon që subjekti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të deklaruara. Në të kundërt, burimi, dhe pasuria e krijuar do të konsiderohen të paligjshme dhe, për rrjedhojë, krijohen kushtet e pamjaftueshmërisë për kriterin e kontrollit të pasurisë.

21.2 Në konkluzion për pasurinë apartament banimi, me sip. 99.5 m², në Qerret, Kavajë, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm këtë pasuri në pronësi të saj, nuk arriti të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit dhe ka kryer deklaram të pasaktë për kohën e përfitimit të pronësisë mbi këtë pasuri.

22. Në pikën 138 të vendimit të Komisionit është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit për periudhën e deklaramit, për të cilën argumentet e mia kundër janë si vijon:

I. Lidhur me analizën financiare të vitit 2010 ka dy situata në të cilat kam ndarë mendim të ndryshëm nga shumica e trupit gjykues, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, si më poshtë:

23. Situata e parë i përket depozitës tri-mërore të krijuar në këtë vit në vlerën 20.000 euro, në emër të fëmijëve të bashkëshortit dhe të gjyshes së tyre, për të cilën në referencë të nenit 199, paragrafi 2, të Kodit Civil, i cili parashikon: *“Pjesët e bashkëpronarëve janë të barabarta, gjersa nuk vërtetohet e kundërta”*, pjesa takuese e fëmijëve të bashkëshortit në këtë depozitë të krijuar në vitin 2010, (2/3) e depozitës duhet të shpjegohej dhe të provohej nëpërmjet burimit të ligjshëm të krijimit për këtë pjesë takuese, bazuar në parashikimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

23.1 Shumica e trupit gjykues, për efekt të pasqyimit korrekt të pasurive të z. S.S., ka përfshirë te këto llogari tri-mërore te seksioni i pasurive dhe njëkohësisht te të ardhurat duke arsyetuar se impakti i këtij veprimi është zero. Kam vlerësuar se nuk do të rezultonte i njëjti impakt financiar nëse referuar legjislacionit në fuqi, pjesa takuese (2/3) e fëmijëve në depozitën tri-mërore do të konsiderohej si shpenzim i familjes për atë vit financiar.

24. Për sa i përket shpenzimeve mjekësore për znj. E.S., të kryera në vitin 2010 bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, kam ndarë mendim të ndryshëm nga shumica e trupit gjykues për sa nuk janë përlllogaritur në analizën financiare shpenzime mjekësore të saj, për ndërhyrjen kirurgjikale të kryer pranë spitalit “***”, në Philadelphia, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për arsye se:

24.1 Aktet⁴ e paraqitura nga subjekti në cilësinë e provës, për të pasur vlerë provuese duhet të ishin paraqitur në formën e kërkuar ligjore sipas kërkesave të Konventës së Hagës, miratuar me ligjin nr. 9060, datë 8.5.2003, *“Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtarë të huaja”*, si dhe duhet të ishin përkthyer⁵ në gjuhën shqipe.

⁴ Komunikime elektronike të datës 15 shtator 2019 dhe në vijim, si dhe një akt pa datë lëshuar nga kirurg pediatrik.

⁵ Neni 1, pika 2, e ligjit nr. 49/2012, *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar,

24.2. Shpenzimet mesatare për ndërhyrje mjekësore të tilla, variojnë në vlerë të lartë, pa përfshirë kosto që lidhen me vizitat mjekësore, kosto radiologjike, skaner, etj, ndaj nëse ato përfshiheshin në analizën financiare do të sillnin balancë negative financiare për vitin 2010.

24.3. Nga faqja e spitalit “****” Philadelphia,⁶ rezultoi se ky spital është krijuar për të ndihmuar dhe për të dhënë asistencë fëmijëve të një kategorie vulnerabël, ato në nevojë, me objekt kujdesin parësor të shëndetit ortopedik. Ndihma financiare e këtij spitali përcaktohet në përputhje me procedurat⁷ e caktuara dhe kryhet mbi një vlerësim individual të nevojave financiare nëpërmjet një procesi aplikimi, i shoqëruar me paraqitjen e dokumentacionit financiar të kërkuar, nga pacienti, me qëllim evidentimin e pamundesise ekonomike e mundësimin e burimeve alternative të pagesës nga programe financimi publike dhe private.

24.4. Mbi këtë bazë, pacienti/familjari i tij paraqet dokumentacion mbështetës mbi të ardhurat vjetore familjare dhe çdo dokument apo informacion tjetër i kërkuar, në kuadër të realizimit të procedurave për vlerësimin e kriterit financiar me qëllimin final përfitimin nga programet falas, të dedikuara për shtresat në nevojë, për bamirësi “charity”.

24.5 Në konkluzion në analizën financiare të kryer për vitin 2010 duhet të përfshiheshin shpenzimet për pjesën takuese të fëmijëve të bashkëshortit në depozitën tri-mërore të krijuar në këtë vit, dhe shpenzimet e ndërhyrjes mjekësore, për sa subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor provues mbulimin e këtyre shpenzimeve.

II. Lidhur me analizën financiare të vitit 2011

25. Për vitin 2011, Komisionit i ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur mundësi për të përballuar shpenzimet jetike dhe për të kursyer likuiditete *cash* ose në llogaritë bankare, dhe për shpenzime të tjera, duke rezultuar me bilanc negativ në vlerën 859.322 lekë.

26. Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe në paragrafin 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit iu kalua barra e provës, me qëllim që të paraqiste shpjegime dhe prova të tjera për të provuar të kundërtën për këtë pamjaftueshmëri financiare për vitin 2011.

27. Gjithashtu subjektit iu kalua barra e provës, të paraqiste shpjegime dhe prova të tjera për të provuar të kundërtën lidhur me mospërputhjet, e deklarimeve për kostot e ndërtimit, dhe mobilimit të shtesës me sip. 81.69 m², me adresë: Rr. “****”, Tiranë, si vijnë:

27.1 Në deklaratën e pasurisë “Vetting”, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“apartament banimi me sip. 81.69 m² shtesë kati mbi objektin ekzistues, me vlerë 1.638.095 lekë referuar situacionit, me burim nga të ardhurat familjare”*

27.2 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“depozituar në zyrat e ALUIZNI-t një kërkesë për banorët e pallatit për legalizimin e ndërtimit të kryer brenda kushteve teknike, si rrjedhojë e rikonstruksionit të çatisë së pallatit. PAGESA PËR pjesën me sip. prej 85 m² nuk është kryer ende, për arsye se është caktuar për t’u paguar në vitin 2011”*

27.3 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: ***“mobilim shtëpi banimi për vitin 2011, në vlerën 2.000.000 lekë.”***

27.4 Në deklaratën periodike vjetore para fillimit të detyrës të datës 18.12.2014, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“legalizuar apartamenti në vlerën 2.000.000 lekë, deklaruar në vitin 2010, si shtesë kati në proces legalizimi dhe në vitin 2011 si pagesë e kryer për ndërtim e mobilim”*

Neni 266 i Kodit të Procedurave Civile. Shkresa në gjuhë të huaj (kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhë shqipe, të legalizuar nga ambasada apokonsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent).

⁶ www.shrinershospitalsforchildren.org

⁷ <https://www.shrinershospitalsforchildren.org/shc/financial-assistance- Summary of Financial Assistance>,

28. Kam ndarë mendim se në kuptim të ligjit nr. 84/2016, analiza e këtyre gjetjeve, mbas analizimit të shpjegimeve të subjektit, duhet të bëhet integrale, për sa ato afektonin njëra-tjetrën.

29. Pas administrimit të provave dhe shpjegimeve, konkluzioni i shumicës për mospërputhjet e mësipërme ishte se, deklarimi i destinacionit të përdorimit të kësaj shume nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në deklarin periodik vjetor të vitit 2011, vlerësohet të mos jetë i qartë në raport me deklarinmet e tij ndër vite, para dhe pas këtij deklarimi, paqartësi kjo që nuk rezultoi të jetë bërë në mënyrë të qëllimshme, prandaj, si e tillë, nuk mund të shërbejë për të pranuar të kundërtën e asaj që rezultoi në fakt nga deklarinmet në tërësi të tij, pra, për t'i dhënë këtij deklarimi një vlerë të paracaktuar dhe më të fortë provuese në raport me deklarinmet e të njëjtit lloj dhe të deklaratës “Vetting”.

29. Kam ndarë mendim të ndryshëm nga shumica e trupit gjykues në kuptim të ligjit nr. 84/2016, për arsyetimin e mësipërm, bazuar në jurisprudencën e konsoliduar dhe të harmonizuar të Kolegjit të Apelit të cilat ka shtjelluar në mënyrë shteruese se:

29.1 Në vendimin nr. 7/2018, Kolegji përcaktoi se: “[...] dispozitat kushtetuese dhe ligjore për procesin e rivlerësimit për kriterin e pasurisë, në asnjë rast nuk e lidhin pamjaftueshmërinë e deklarinmet me elementet subjektive të dashjes apo qëllimit. Procesi i rivlerësimit është një procedurë administrative/sanksionuese (dhe asnjëherë një proces penal), e cila ofron të gjitha garancitë e një procesi të rregullt ligjor. Në lidhje me deklarinmet e pasurisë, ligji nuk ka pasur në qëllim të tij përcaktimin e rrethanave lehtësuese apo rënduese, të lidhura me dashjen apo qëllimin, pasi, në të kundërt, do të kishte bërë përcaktime të tilla si në nenin 38, për standardet e kontrollit të figurës [...]”.

29.2 Në vendimin nr. 9/2019, Kolegji përcaktoi se: “[...] saktësia e deklaratave të subjektit është e rëndësishme për të kuptuar saktësisht gjendjen reale financiare të tij dhe për të vërtetuar nëse ai ka pasur burime të mjaftueshme dhe të ligjshme për krijimin e pasurisë. Jo pa qëllim, ligji e ka ngarkuar subjektin me detyrimin për të kryer deklarinmet të saktë dhe të plotë. Leximi veçmas apo në harmoni i dispozitave kushtetuese dhe atyre të ligjit nr. 84/2016, përfshirë edhe dy dispozitat e sipërpërmendura, nuk duket se lënë vend që institucionet e rivlerësimit të hetojnë qëllimin e subjekteve në procesin e deklarinmeve të interesave periodike vjetore ndër vite [...]”.

30. Për sa subjektin e rivlerësimit nuk arriti të provojë edhe pas kalimit të barrës së provës, lidhur me faktet kontradiktore për vlerën e krijimit të pasurisë dhe mobilimit të saj, pasqyrimi i këtyre vlerave duhet të kryhet bazuar në dokumentacionin që ka vlerën e provës si më poshtë:

31.. Deklarimi i bërë në deklaratën “Vetting” për vlerën e ndertimit të kësaj pasurie apartament prej 1.638.095 lekësh, rezultoi i provuar bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit prej subjektin të rivlerësimit, situacioni i punimeve.

32. Vlera e ndertimit të kësaj pasurie prej 1.638.095 lekësh, rezultoi e provuar nga marrëveshja noteriale hartuar mes palëve në datën 22.9.2011, sipas të cilës, z. H.Sh., mori përsipër t'i njohë të drejtën e pronësisë z. S.S., mbi ½ e sipërfaqes ndërtimore ndertuar prej tij, ndërsa z. S.S., mori përsipër t'i paguajë deri në fund të dhjetorit 2011, z. H.Sh., vlerën e punimeve të kryera sipas preventivit.

33. Për sa më sipër, në analizën përfundimtare financiare të vitit 2011, duhet të merrej në konsideratë vlera 1.638.095 lekë, si kosto faktike e ndertimit për këtë apartament banimi me sip. 81.69 m² shtesë kati .

34. Në deklaratën “Vetting” nuk deklarohen kosto mobilimi për këtë apartament banimi me sip. 81.69 m² shtesë kati .

35. Kosto e mobilimit për këtë apartament banimi me sip. 81.69 m², shtesë kati, rezultoi e provuar në deklarinmet periodik të bashkëshortit të subjektin në vitin 2011, deklarim i cili merr

vlerën e provës në referim të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, dhe sipas Kodit të Procedurës Civile, shërben për të arritur në konkluzion në lidhje me kostot e ndertimit e mobilimit të pasurisë. (dhe në DPV-2014 deklarimi i bërë referon te deklarimi i bërë në 2011)

36. Në dokumentacionin justifikues bashkëlidhur deklaratës së rivlerësimit prej subjektit të rivlerësimit, situacioni i punimeve, konfirmon vlerë monetare prej 1.638.095 lekësh për punime që nuk përfshinin kosto pajisjesh hidrosanitare, pajisjesh elektrike dhe kosto të tjera të domosdoshme për bërjen funksionale dhe të jetueshme të saj, ndaj ishte brenda konceptit logjik, vlera e deklaruar për mobilimin e kësaj banese në vitin 2011, prej 2.000.000 lekë, e cila duhet të përfshihej në analizën financiare të vitit 2011, si zë më vete, kosto e mobilimit për këtë vit.

37. Për sa më sipër, në analizën përfundimtare financiare të vitit 2011 duhet të merrej në konsideratë vlera 2.000.000 lekësh, si kosto mobilimi për këtë apartament me sip. 81.69 m².

38. Në përmbledhje analiza financiare përfundimtare për vitin 2011, rezulton si më poshtë:

	Përshkrimi	Analiza financiare	2011
1	PASURI		1,150,556
		<i>Shtesa/pakësime/ likuiditete</i>	1,150,556
		Total likuiditete në fillim të vitit	9,240,343
		Total likuiditete në fund të vitit	10,390,899
2	DETYRIME		0
3	PASURI NETO (1-2)		1,150,556
4	TË ARDHURA		3,871,093
		Të ardhura të dokumentuara Edlira Petri	750,602
		Të ardhura të dokumentuara S. S.	3 737 358
5	SHPENZIME		5,217,953
		Paguar për ndërtimin e shtesës shtetasi H.Sh., ne vitin 2011	1,638,095
		Mobilim apartamenti deklaruar në DPV-në e vitit 2011	2,000,000
		Shpenzime legalizimi shtese kati 81 m ²	15,957
		Shpenzime legalizimi apartamenti Qerret	68,499
		Tatim për rivlerësimin e pasurisë “***” 186 m ²	230,083
		Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	683,100
		Shpenzime udhëtimi TIMS (subjekti + bashkëshorti dhe fëmijët)	541,693
		Shpenzime AMEX (kartë krediti Credins Bank) S. S.	40,526
6	KURSIME		
	DIFERENCA (TË ARDHURA – PASURI - SHPENZIME 4-3-5-6)		-1.880.550

39. Me të ardhurat e ligjshme, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore sipas përcaktimit të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, në vitin 2011 subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur mundësi për të përballuar shpenzimet dhe për të kursyer likuiditete *cash* ose në llogaritë bankare duke rezultuar me bilanc negativ, në vlerën -1.880.550 lekë,

40. Përveç sa më sipër, lidhur me burimin e krijimit, përkundër deklaramit në deklaratën “Vetting” se burim krijimi i kësaj pasurie ishin të ardhurat familjare, pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ishte detyrimi monetar kundrejt z. H.Sh., përmbushur në vitin 2011, ai që mundësoi ndërtimin e kesaj shtese.

41. Në sa me siper deklaruar nga subjekti e në kuptim të parashikimeve të legjislacionit në fuqi, detyrimi ndaj shtetasit H.Sh., në kuptim të parashikimeve të legjislacionit në fuqi, duhej të ishte deklaruar si burim krijimi i kësaj pasurie.

42. Deklarimi i subjektit se si burim i krijimit në deklaratën “Vetting” për apartament banimi me sip. 81.69 m² shtesë kati, në **Tiranë**, ishin të ardhurat, ishte i gabuar dhe nuk përkonte në kohë.

III. Lidhur me analizën financiare të vitit 2014

43. Kam vlerësuar se analiza financiare e vitit 2014 duhej kryer mbi analizën paraprake të gjendjes *cash* deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting” e deklarimet periodike vjetore. Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë deklaruar, ndër vite, likuiditete në gjendjen *cash*, në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar sipas tabelës më poshtë.

Përshkrimi i gjendjes CASH sipas DPV Vjetore nga subjekti e bashkeshorti	CASH
Në DPV 2011 S.S., deklararon “Gjendje Cash shtuar në vitin 2011”	1,000,000
Gjendje cash më 31.12.2011	1,000,000
Ne DPV te vitit 2012 nuk deklarohen shtesa / pakësime cash.	0
Gjendje cash më 31.12.2012	1,000,000
Ne DPV 2013 subjekti deklararon “Gjendje Cash shtuar nga tërheqjet në llogarinë rrjedhëse të pagës” 200,000 lekë	200,000
Ne DPV te vitit 2013 S.S., deklararon “Gjendje cash shtuar nga tërheqjet në llogaritë rrjedhëse sipas vërtetimeve në dt 31.12.2013” 1,000,000 lekë	1,000,000
Ne DPV te vitit 2013 S.S., deklararon “Gjendje cash shtuar nga tërheqjet në llogaritë rrjedhëse sipas vërtetimeve në dt 31.12.2013” 5,000 euro	701,050
Gjendje cash më 31.12.2013	2,901,050
Në DPFD të vitit 2014 S.S., deklararon “Gjendje Cash 5,000 euro”	700,550
Ne DPV 2014 nuk deklarohen shtesa / pakësime / Gjendje cash më 31.12.2014	3,601,600
Ne DPV 2015 nuk deklarohen shtesa / pakësime te gjendjes cash.	0
Gjendje cash më 31.12.2015	3,601,600
Ne DPV 2016 nuk deklarohen shtesa / pakësime cash.	0
Gjendje cash më 31.12.2016	3,601,600

44. Nuk rezulton të jenë deklaruar në asnjë prej deklarimeve periodike vjetore nga subjekti rivlerësimit dhe bashkëshorti pakësimi i ketyre likuiditeteve në gjendjen *cash*.

44.1 Për sa më sipër, përkundër deklarimit të subjekti i rivlerësimit në Vetting, se nuk ka pasur kursime në gjendje cash në banesë, rezulton se referuar deklarimeve periodike, gjendje cash në banesë, në momentin e plotësimit të Deklarata Vetting ka qënë 3,601,600 lekë.

45. Në deklarimin periodik para fillimit të detyrës së bashkëshortit të rivlerësimit në vitin 2014, rezulton të jetë deklaruar gjendja *cash* prej 5.000 euro dhe në vijim nuk rezulton të jetë deklaruar pakësim i kësaj gjendje *cash* në fund të vitit 2014, në formularin e deklaratës së pasurisë, në seksionin “Ndryshimet e interesave private pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”.

46. Ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, ndër vite, përcaktojnë detyrimin e deklarimit të çdo ndryshimi të mundshëm të gjendjes së kursimeve *cash*, nëse kjo kishte ndodhur në vitin respektiv.

47. Kolegji i Posaçëm i Apelit ka trajtuar në disa vendimmarrje duke orientuar Komisionin, në bazë të së drejtës së njohur nga pika 2, e nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, “*Të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve cash, si burime për mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklarata periodike*”.

48. Në analizën përfundimtare financiare, të kryer për vitin 2014 për subjektin e rivlerësimit, duhet të përfshiheshin jo vetëm shpenzimet për shkollimin e fëmijëve; huaja dhënë motrës së bashkëshortit të subjektit, shpenzimet jetike dhe të udhëtimit por dhe gjendja *cash*, deklaruar në vitin 2014 në vlerën 5.000 euro.

49. Në përmbledhje analiza financiare përfundimtare për vitin 2014, rezulton si më poshtë:

	Përshkrimi	Analiza financiare	2014
1		PASURI	4,797,191
		Shtesa/pakësime/ likuiditete	4,797,191
		Total likuiditete	18,843,692
2		DETYRIME	-1,120,880
		Dhënie huaje motrës në Kanada 8,000 euro	-1,120,880
3		PASURI NETO (1-2)	5,918,071
4		TË ARDHURA	7,486,638
		Të ardhura të dokumentuara Edlira Petri	1,236,357
		Të ardhura të dokumentuara S. S.,	4,656,502
		Të ardhura nga interesat bankare Edlira Petri	46,124
		E ardhur E.S., sipas vendimit të Gjykatës “Alpha Bank”, më 30.12.2014	773,828
		E ardhur K.S., sipas vendimit të Gjykatës “Alpha Bank”, më 30.12.2014	773,828
5		SHPENZIME	3,371,852
		Shpenzime shkollimi dhe jetese E.S., *** Austri	919,122
		Shpenzime shkollimi S.S.,	420,330
		Shpenzime shkollimi K.S.,	83,502
		Shpenzime pushimesh jashtë vendit	490,385
		Takse ndërtimi Golem	84,800
		Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	989,991
		Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	358,301
		Shpenzime AMEX (kartë krediti Credins) S.S.,	25,422
		DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME (4-3-5))	-1,803,285

50. Me të ardhurat e ligjshme, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore sipas përcaktimit të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, në vitin 2014, subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur mundësi për të përballuar shpenzimet dhe kursyer likuiditete *cash* ose në llogaritë bankare, duke rezultuar me një bilanc negativ, në vlerën -1,803,285 lekë.

KONKLuzion

Mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që disponohen për kriterin e vlerësimit të pasurisë, si anëtare në pakicë/kundër, arrij në përfundimin se:

- Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues për të vërtetuar burimin e ligjshëm të krijimit të të pasurisë së paluajtshme, ndodhur në Qerret, Kavajë si dhe ka bërë deklaram të pasaktë për kohën e fitimit të pronësisë së kësaj pasurie të paluajtshme në deklaramen “Vetting”.
- Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaramen “Vetting” lidhur me burimin e krijimit të pasurisë të paluajtshme, apartament banimi me sip. 81.69 m², shtesë kati, ndodhur në Tiranë, pasi nuk ka deklaruar detyrimin ndaj shtetasit H.Sh., si burim krijimi për këtë pasuri.
- Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të kursimeve në gjendje cash në banesë, në Deklaramen Vetting, si dhe rezulton me pamundësi financiare për të mbuluar me të ardhura të ligjshme, shpenzimet dhe kursimet e deklarama për vitin 2011 në vlerën -1.880.550 lekë dhe për vitin 2014 në vlerën -1.803.285 lekë (gjithsej për të dy vitet në vlerën **-3.683.835 lekë**).

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në konkluzionet e mësipërme, në mbështetje të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Edlira Petri, nuk ka arritur nivel të besueshëm në rivlerësimin e pasurisë dhe ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me këtë kriter, ndaj duhej disponuar me shkarkimin nga detyra të saj.

Xhensila PINE

Anëtar/Kundër